

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"YELLOW MOOD 25" SH.P.K."

KAPITULLI 1

Dispozita te Pergjitheshme

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "Yellow Mood 25" sh.p.k., eshte themeluar sipas akt themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruara nga ortaket e saj bazuar ne "Ligjin" Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

NENI 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 08.10.2020, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Shoqeria do të emerohet "Yellow Mood 25" sh.p.k.

Themeluesit e shoqërisë janë:

1. Shoqeria "Yellow Mood" shpk, e regjistruar pranë regjistrimit tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) nr. L92104008T, me seli në Shqipëri ne adresen Rruga Xhebrahimi, Sauk, Nr. Pasurie 370/12, Zona Kadastrale 3266, Volumi 31, Faqja 201, e perfaqesuar nga Z. Evis Mumajesi, i biri i Fadil, lindur më datë 30/03/1979 në Tiranë dhe banues ne Tiranë, madhor e me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i Letërnjoftimit me nr. 030542464 identifikuar me nr. Personal H90330209J.

2.- Z. Kledi Bahiti, lindur më datë 04/04/1987, në Elbasan dhe banues në Tiranë, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 034099214 dhe me Nr. Personal I70404096U, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar,

Neni 2

Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë vijon:

- ushtrimin e aktivitetit vetëm për shitjen në restorant dhe shërbim taxi të produkteve ushqimore (i.e ushqim, pije, kafe) të brendit Yellow Mood sipas Rregullores së Brendshme që kompania mëmë Yellow Mood shpk zotëron.
- ushtrimin e aktivitetit vetëm për shitjen dhe shpërndarjen e Produkteve Tregtare Yellow Mood, (shërbim taksi dhe shërbim në vend);



- bar-kafe, restorant vetëm me Produktet Tregtare Yellow Mood;
- çdo aktivitet tjetër të nevojshëm për realizimin qëllimit të Shoqërisë.

Neni 3 **Adresa e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë është në adresën “Sheshi Italia, Stadiumi Air Albania”, Tiranë.

Shoqëria, me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, mund të zhvendosë selinë e saj ose të krijojë një seli operative në një vendndodhje tjetër në Republikën e Shqipërisë. Shoqëria mund të hapë degë dhe zyra përfaqësimi kudo brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë, me miratim paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 4 **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pakufizuar. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë kufizim kohor në jetëgjatësinë e Shoqërisë.

Neni 5 **Forma Ligjore**

Shoqëria është e formës me përgjegjësi të kufizuar (SH.P.K.), në përputhje me dispozitat e Nenit 68 e në vazhdim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.


Shoqëria mund të shndërrohet në një formë tjetër me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, sipas dispozitave të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 6 **Baza Ligjore**

Shoqëria “Yellow Mood 25” SH.P.K, do të kryejë veprimtarinë e saj në përputhje me këtë Statut, Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodin e Drejtimit të Brendshëm të Shoqërive Tregtare (Corporate Governance Code), siç është miratuar me vendimin nr. 1, datë 02.12.2011 të Këshillit Konsultativ të Biznesit, të gjitha dispozitat e tjera të detyrueshme në bazë të legjislacionit shqiptar, marrëveshjen e Ortakëve.

Neni 7 **Emblema dhe Vula**

Shoqëria do të ketë emblemen dhe vulën e saj. Vula do të përdoret nga Administratori. Forma e vulës dhe përmasat e saj do të përcaktohen nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore në Shqipëri.



KREU II. KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 8 **Kapitali**

Kapitali fillestar i Shoqërisë është në para. Ky kapital, për pjesën e kontributit në para, është tërësisht i shlyer nga Ortakët, përpara regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar.

Kapitali i Shoqërisë, sipas marrëveshjes së ndërsjelltë të Ortakëve, është në vlerën 130.000 Euro, (njëqind e tridhjetë mijë euro), i ndarë në 2(dy) kuota.

Ortaku **"Yellow Mood" SH.P.K** zotëron një kuotë që përfaqëson 75 % (shtatëdhjetë e pesë përqind) pjesë të kapitalit themeltar të Shoqërisë, që është e barabartë me 97.500(nentedhjetë e shtatë mijë e pesëqind) euro. Ky ortak e ka kontributin e tij në para.

Ortaku **Kledi Bahiti** zotëron një kuotë që përfaqëson 25 % (njëzetë e pesë përqind) pjesë të kapitalit themeltar të Shoqërisë, që është e barabartë me 32.500(tridhjetë e dy mijë e pesëqind) euro. Ky ortak e ka kontributin e tij në natyrë.

Sipas marrëveshjes së ndërsjelltë të ortakëve për vlerën 32.500(tridhjetë e dy mijë e pesëqind) euro, ortaku Z. Kledi Bahiti do kontribuoj nëpërmjet menaxhimit dhe administrimit të mirë të shoqërisë. Llogaritja e kohës, rezultatit të punës dhe të drejtat që burojnë nga kuota për Z. Kledi Bahiti do të bëhet sipas "Aneksit 1", i cili është një raport midis kontributit në natyrë dhe rezultatit të punës së ortakut Z. Kledi Bahiti bashkëlidhur këtij statuti.

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar në para janë shlyer me para dhe janë paguar plotësisht përpara nënshkrimit nga Ortakët. Nënshkrimi dhe shlyerja e pjesëve të mëtejshme të kapitalit mund të bëhet me para ose me kontribute në natyrë, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 9 **Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar**

Pjesët e kapitalit themeltar mund të transferohen vetëm me akt noterial.

Pjesët e kapitalit transferohen automatikisht në rrugë trashëgimie.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet Ortakëve të Shoqërisë, si dhe shoqërive të kontrolluara prej tyre në rast se ka të tilla.

Pjesët e kapitalit themeltar mund t'i transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në Shoqëri, kjo vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që përfaqësojnë të paktën 51% e pjesëve të kapitalit themeltar.

Transferimi për cdo lloj arsye, tërësisht apo pjesërisht i pjesëve të kapitalit të shoqërisë

Çdo transferim i kapitalit themeltar bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 10
E drejta e parablerjes

Nëse një ortak nuk ka shlyer kapitalin e tij qoftë në para ose në natyrë ai nuk mund t'a transferoj kapitalin e tij në asnjë nga mënyrat e përcaktuara në ligj dhe në këtë statut sipas Nenit 11.

Transferimi për çfarëdo arsye, tërësisht ose pjesërisht i pjesëve të kapitalit të Shoqërisë, është subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të ortakut tjetër, i cili mund të ushtrojë këtë të drejtë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga marrja e njoftimit të dërguar me letër rekomandë (lajmërim marrje), i cili përmban çmimin, blerësin e mundshëm dhe mënyrën e pagesës.

Në rast se ortaku i cili mban të drejtën e parablerjes nuk përgjigjet brenda afatit 30 (tridhjetë) ditor të lartpërmendur, atëherë konsiderohet se ai ka hequr dorë nga e drejta e parablerjes së pjeseve të kapitalit që do të tjetërsohen.

Neni 11
Zmadhimi i kapitalit themeltar

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën ekskluzive për të marrë vendimin për zmadhimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë. Kapitali themeltar i Shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve në para apo në natyrë, në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Ortakët mund të rrisin pjesën e tyre në kontributin e kapitalit themeltar vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me pjesëmarrjen e ortakëve që përfaqësojnë të paktën 51% të kapitalit të Shoqërisë.

Zmadhimi i kapitalit i realizuar nga njëri prej ortakëve nuk i detyron ortakët e tjerë të rrisin edhe ata pjesën e tyre.


Vendimi i zmadhimit të kapitalit themeltar mund të sjellë edhe riorganizimin e numrit dhe vlerës së secilës pjesë të tij dhe zotërimin e tyre nga ortakët.

Rritja e kapitalit themeltar mund të realizohet edhe nëpërmjet nënshkrimit dhe shlyerjes së pjesëve të reja të kapitalit nga ortakë të rinj. Ortakët e rinj do të pranohen si të tillë me vendim unanim të ortakëve në të njëjtën mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme që miraton zmadhimin e kapitalit themeltar.

Neni 12
Zvogëlimi i kapitalit themeltar

Zvogëlimi i kapitalit themeltar bëhet ekskluzivisht me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Kapitali themeltar nuk mund të jetë më i vogël sesa minimumi i përcaktuar sipas Nenit 10, përndryshe Shoqëria është e detyruar që të ndryshojë formën e saj juridike apo të shpërbëhet në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Zvogëlimi i kapitalit miratohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, me pjesëmarrje të ortakëve që përfaqësojnë 51% të kapitalit themeltar të Shoqërisë. Zvogëlimi i kapitalit do të bëhet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".



KREU III
ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 13
Organi Vendimmarres

Shoqëria është e organizuar ne organet e meposhteme:

- 1- Asambleja e Ortakeve Te Shoqerise
- 2- Bordi Drejtues
- 3- Administratori

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e pergjithshme e ortakeve është pergjegjese për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme ne perputhje me nenin 10 dhe 11 te statutit:

- a) percaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- dh) percaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë dhe shperndarja e fitimit/humbjes vjetore;
- g) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- i) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- l) emerimi dhe shkarkimi i anetareve te Bordit Drejtues
- m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortakët mund të përfaqësohen në asamblenë e pergjithshme, nga një person i tretë me autorizimin perkates. Administrastoret e shoqerise nuk mund te veprojne si perfaqesues te ortakeve ne asamblene e pergjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së pergjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 14

Thirrja dhe Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme

Mënyra e thirrjes, mbledhja dhe regjistrimi i vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme bëhen në përputhje me dispozitat e neneve 81, 82 dhe 83 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi duhet të përmbajë orën, datën, vendin e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

Lajmërimi bëhet nga Administratori i Shoqërisë. Njoftimi do të dërgohet në adresën që rezulton në Librin e Shoqërisë.

Në rastin kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas specifikimeve të mësipërme, atëherë Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët bien dakort për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.

Mbledhja e Asamblesë mund të bëhet edhe sipas rregullave procedurale të mbledhjes të miratuara nga vetë Asambleja e Përgjithshme.

NENI 15

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 51% për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se 51% te numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

NENI 16

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me 51% te votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës ceshtjet e meposhteme:

1. për ndryshimin e statutit
2. zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar
3. shpërndarjen e fitimeve
4. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.



Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, sipas nenit 10 pika 1, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- h) emërimin dhe shkarkimin e anetareve të Bordit drejtues të shoqërisë

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

NENI 17

Përgjithshmi nga e drejta e votës

1.Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Neni 18



Administratori

Shoqëria do të administrohet për një afat 5 vjeçar nga data e regjistrimit të kësaj shoqërie pranë QKB-se nga Administratori **Z.Kledi Bahiti**, lindur me 04/04/1987, në Elbasan, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 034099214 dhe me Nr. Personal I70404096U, madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar i emëruar në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, dt.14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare". Numri i administratorëve do mund të ndryshohet sa here që Asambleja e Përgjithshme e gjykon të arsyeshme.Administratori mund të jetë i cdo kombësie dhe emërohet për një periudhë jo më të gjatë se 5(pesë)vjet, me të drejtë rrimimi.

Në rast dorëheqjeje, pushimi nga puna apo skualifikimi të ndonjë Administratori, pasardhësi që do të zërë vendin e Administratorit do të zgjidhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, menjëherë pas kësaj ngjarjeje, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Asambleja e Përgjithshme me 30% të votave ka të drejtë që nëpërmjet një vendimi të marrë me shkrim, të përfundojë para afatit mandatin e njërit ose të gjithë Administratorëve, pa pasur nevojën dhe detyrimin të shtrojë arsye të motivuar për këtë shkarkim.

Pas pranimit të emërimit, Administratorët do të deklarojnë me shkrim që marrëdhënia e tyre me Shoqërinë është ngritur mbi baza besimi. Në këtë kontekst, vendimi për t'i shkarkuar Administratorët me anë të një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të pamotivuar, gjykohet si një arsye legjitime për heqjen e tyre, në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse.



Shoqëria mund të përfaqësohet nga 1 (një) Administrator edhe në qoftë se do të emërohen më shumë se 1 (një) Administratorë, ose nga të gjithë Administratorët e emëruar.

Administratorit i janë dhënë të gjitha tagrat për të vepruar, me qëllim për të krijuar marrëdhënie me palët e treta për interes të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat, përveç kur këto tagra kufizohen në përgjithësi nga ligji dhe përveç atyre të cilat në menyrë të shprehur u përkasin Asamblesë së Përgjithshme me ligj, akte të Shoqërisë, ose kanë një rëndësi të tillë për të cilat miratimi i Asamblesë së Përgjithshme është i domosdoshëm. Këto kufizime tagrash të Administratorit (ëve) i kundrejtohen palëve të treta.

Aktiviteti i përditshëm i Shoqërisë kryhet nga Administratori (Administratorët) duke përfaqësuar apo vepruar në emër të Shoqërisë me palët e treta, institucionet publike apo private, duke hyrë në marrëveshje si dhe duke përfaqësuar Shoqërinë përballë gjykatave të shkallëve të ndryshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë.

Kompetencat e Administratorit (Administratorëve) që përfaqëson/përfaqësojnë Shoqërinë për këtë qëllim përfshijnë:

- Të veprojë dhe nënshkruajë në emër të Shoqërisë; të punësojë apo të shkarkojë punonjësit e Shoqërisë;
- Të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- Të përfaqësojë Shoqërinë;
- Të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe menaxhimin e tyre;
- Të nënshkruajë bilancin vjetor, eventualisht bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesë këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- Të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
- Të kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- Të mbajë një regjistër ku të regjistrohen emri i plotë i ortakëve, emri i Shoqërisë, vendbanimi apo selia e ortakëve, përqindja përkatëse e interesit në kapitalin themeltar të Shoqërisë, transferimi i kuotave apo çdo ndryshim i të dhënave të mësipërme;
- Të raportojë përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe në lidhje me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi thelbësore për veprimtarinë e Shoqërisë;
- Të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme sa herë që e detyron ligji si dhe për marrjen e vendimeve që duhet miratimi i saj;
- Të kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në Statut, pa ndërhyrë kurrësesi në kompetencat që me ligj apo Statut i janë dhënë Asamblesë së Përgjithshme.

Asambleja e Përgjithshme, në rast të shtimit të numrit të Administratorëve, mund të miratojë një vendim për t'u dhënë të gjithë Administratorëve kompetencë të përbashkët përfaqësimi.

Çdo Administrator, në kryerjen e aktiviteteve të tij përkatëse, duhet të jetë në konformitet me ligjin, rregullat e drejtimit që rregullojnë ndarjen e aktivitetit dhe procedurave për vendimet e drejtimit, të miratuara me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Çdo Administrator do të drejtojë aktivitetin e Shoqërisë dhe do të sigurojë zbatimin e të gjithë urdhrave dhe vendimeve të Asamblesë së Përgjithshme.

Çdo Administrator do të kryejë edhe detyra të tjera siç mund të parashtrihen nga Asambleja e Përgjithshme, dhe gjatë drejtimit normal të aktivitetit, mund të delegojë një pjesë të kompetencave dhe të drejtave të tij përkatëse tek një ose disa zyrtarë të Shoqërisë, në përputhje me rregullat e procedurës së drejtimit që rregullojnë ndarjen e aktivitetit dhe me procedurën për vendimet e drejtimit, të miratuara me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

Aktet dhe masat që tejkalojnë veprimtarinë e zakonshme të aktivitetit të Shoqërisë janë objekt i miratimit paraprak të Asamblesë së Përgjithshme.

Administratori (Administratorët) është/janë përgjegjës përkundrejt Shoqërisë dhe çdo personi të tretë për çdo shkelje të ligjit apo akteve të Shoqërisë, gjatë ushtrimit të funksionit të tyre në Shoqëri, siç parashikohet në dispozitat e Nenit 98 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Administratori mban individualisht përgjegjësi përballë Shoqërisë ose të tretëve për shkeljet e mundshme të ligjit dhe/ose të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të Shoqërisë.


Administratori mund të zëvendësohet në çdo moment me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, votë e marrë kjo me shumicë të zakonshme. Administratori mund të zëvendësohet në çdo moment me vendim të autoriteteve gjyqësore shqiptare për shkelje të ligjit.

Paga e Administratorit si dhe shpërblime të tjera përcaktohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të zakonshme.

Kreu IV **BORDI DREJTUES**

NENI 19 **Objektivat**

1. Bordin Drejtues është organi më i lartë drejtues dhe organizativ i shoqërisë.
2. Ky Bord është krijuar për të ndihmuar, lehtësuar dhe drejtuar menaxhimin e aktivitetit të përditshëm të shoqërisë në të gjitha aspektet.
3. Funksioni i Bordit Drejtues ka si qëllim mbarevajtjen, kontrollin e aktivitetit të përditshëm të shoqërisë si dhe të administratorit të saj.



NENI 20
Pranimet

1. Anetar i Bordit Drejtues do te quhet cdo individ aktiv i cili zgjedhet dhe miratohet nga nje procedure e rregullt e deklaruar me pare nga perfaqesuesit e ortakeve te shoqerise.
2. Me proceduren e perzgjedhjes se aplikimit dhe pranimet per anetar ne Bordin Drejtues ngarkohen perfaqesueset e ortakeve te shoqerise.
3. Zgjedhja e anetareve te Bordit behet nje here ne vit.
4. Numri i pergjithshem i anetareve te Bordit te ri Drejtues do te jete deri ne 5 veta.

NENI 21
Te Drejtat Dhe Pergjegjesite

1. Cdo anetar ka per detyre te marre pjese aktive ne drejtimin dhe mbarevajtjen e aktiviteve te perditshem te shoqerise.
2. Cdo anetar ka te drejte te mireinformohet per pozicionin qe duhet te kete ne cdo situate ku ai merr persiper pergjegjesine te drejtoje nje eveniment te caktuar perfshire kjo ne funksionin e aktiviteve te shoqerise
3. E drejta e fjales dhe degjimit i rezervohet cdo anetari perkundrejt vleresimit te tij nga anetaret e tjere te Bordit Drejtues.
4. Cdo anetar ka te drejte te hedhe ne shqyrtim dhe diskutim cdo eveniment ekzistues te aktivitetit te perditshme te shoqerise.
5. Imuniteti i Bordit Drejtues eshte nje e drejte qe mund t'i percillet cdo anetari te Bordit kur ai ndodhet perballe nje situate qe kerkon nderhyrjen ose bashkeveprimin e menjehershem te Bordit Drejtues. Me rastin e pare ky aksion duhet te deklarohet per te marre miratimin apo sygjerimet e ortakeve te shoqerise.
6. Cdo anetar i bordit ka te drejten te komunikojte direkt me ortaket e shoqerise, per te kerkuar mendimin e tyre per nje ceshtje me interes per te gjitha.
7. Cdo anetar i bordit drejtues ka te drejten te monitoroje dhe te korrigoje qendrimet e administratorit/ve gjate aktivitetit te perditshem te punes kur keto qendrimet shkelin kompetencat e dhena administratorit/ve nga ky statut. Korrigjimi kryhet me terheqjen e vemendjes apo me sygjerimin per shkarkimin nga detyra e administratorit/ve te shoqerise, sygjerim ky qe percillet tek ortaket e shoqerise.
8. Anetaret e bordit, kane te drejten te negociojne me individe apo subjekte te ndryshme per ti sjelle shoqerise sherbime te reja ose per te financuar ato egzistuese.



9. Cdo anetar i Bordit duhet te jete pergjegjes per ruajtjen e personalitetin te tij, konfront cdo rrethane te krijuar.

10. Cdo anetar i Bordit Drejtues e ka per detyre te percoje ne shoqeri me menyren me te mire dhe jo te drejtperdrejte objektivat dhe qellimin e e politikave te shoqerise duke nderhyre me menyren me te mire.

11. Cdo anetar i bordit ka te drejte te nxjerre ne pah dhe terheqi vemendjen nje kolegu brenda bordit per sjellje te papergjegjshme ose jokohere me rregulloret e shoqerise. Sjelljet e papergjegjshme te perseritura jane subjekt marrje masash qe mund te cojne deri ne perjashtim nga bordi drejtues.

NENI 22 Procedurat

1. Votimi eshte procesi me kryesor i vendimarjes se veprimeve nga ana e Bordit Drejtues. Eshte e detyrueshme pjesemarrja e cdo anetari duke dhene mendimin e tij: po, jo, abstenim

2. Cdo anetar ka te drejten hedhjes se nje ceshtjeje per votim si dhe te mbrojtjes dhe te analizimit te vendimit te tij.

3. Cdo anetar ka te drejten e nje vote.

4. Procedura e votimit percaktohet dhe drejtohet vetem nga ortaket e shoqerise me miratimin qe me pare te dy ose me shume anetareve te tjere te Bordit Drejtues.

5. Votimi merr vleren aktive vetem kur nga numerimi, rezulton se me shume se $\frac{2}{3}$ (dy të tretat) e votave perkrahin ose hedhin poshte temen e dhene per shqyrtim.


6. Cdo votim nuk mund te zgjase me shume se tre dite. Ne qofte se pjesemarrja brenda afatit nuk kalon $\frac{2}{3}$ (dy të tretat) e anetareve aktive to Bordit Drejtues, me miratim ose shtyhet edhe 2 dite te tjera afati.

KREU V. VITI FINANCIAR-LIKUIDIMI

Neni 23 Viti financiar

Viti financiar i Shoqërisë përputhet me vitin kalendarik, duke filluar më datë 1 Janar dhe duke mbaruar më datë 31 Dhjetor.

Si përjashtim, viti i parë i veprimtarisë së Shoqërisë do të fillojë nga dita e regjistrimit të Shoqërisë pranë organeve tatimore dhe përfundon më datë 31 Dhjetor.



Neni 24
Bilanci. Mbajtja e kontabilitetit

Administratori do të mbajë llogari financiare të përshtatshme dhe do të përgatisë raporte financiare për të pasqyruar me saktësi gjendjen financiare të Shoqërisë, në përputhje me parimet e kontabilitetit. Llogaritë dhe raportet financiare do të jenë në formë dhe përmbajtje në përputhje me standartet e kontabilitetit, sipas parashikimeve ligjore.

Kontabiliteti mbahet në gjuhën Shqipe dhe në monedhën shqiptare. Shoqëria mund të ketë edhe llogari të veçanta në valutë.

Bilanci vjetor i Shoqërisë shqyrtohet në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe duhet të hartohet për t'iu paraqitur organeve tatimore.

Shoqëria mund të marrë financime nga Ortakët ose nga ortaku i vetëm (në rast të shndërrimit me një ortak), nga institucione financiare që operojnë në Shqipëri ose jashtë saj. Për këtë qëllim Shoqëria mund të japë si garanci barrë mbi pjesët e kapitalit ose sende të paluajtshme, me autorizim të Asamblesë së Përgjithshme.

Neni 25
Ekspertët kontabël të autorizuar

Asambleja e Përgjithshme mund të emërojë të paktën një ekspert kontabël të jashtëm të pavarur, i cili do të jetë një ekspert kontabël i autorizuar (në vijim referuar si “**Eksperti Kontabël i Autorizuar**”). Eksperti Kontabël i Autorizuar do të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:

- Të kontrollojë llogaritë e Shoqërisë, regjistrimet e veprimeve dhe transaksioneve të saj;
- Të vërtetojë, në përputhje me rregulloret përkatëse, raportin vjetor mbi pasqyrat financiare të Shoqërisë (bilancin, pasqyrat financiare të humbjeve dhe fitimeve dhe raporte të tjera që lidhen me to) dhe të japë mendimin e tij nëse pasqyrat financiare pasqyrojnë me saktësi gjendjen financiare të Shoqërisë;
- Të informojë Administratorin(ët) dhe Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë për çdo parregullsi apo mangësi të vërejtur gjatë operacioneve, transaksioneve, procedurave, regjistrimeve apo llogarive të Shoqërisë të cilat mund të rezultojnë në humbje të konsiderueshme për Shoqërinë;
- Të rishikojë përshtatshmërinë e praktikave dhe procedurave të auditimeve dhe kontrolleve të brendshme dhe, nëse është me vend, të japë rekomandime për përmirësimin e tyre;
- Të kryejë të gjitha detyrat e parashikuara nga Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” siç mund të ndryshojë kohë pas kohe.

Neni 26
Të ardhurat. Dividendi

Të ardhurat nga veprimtaria private do të sigurohen sipas çmimeve dhe tarifave që i cakton vetë Shoqëria, por vetëm në përputhje me rregulloren e markës tregtare “Yellow Mood” dhe me politikat e ndjekura nga titullari i markës tregtare “Yellow Mood”.

Fitimet që do të rezultojnë në fund të mbylljes së çdo ushtrimori, të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë, pas pagimit të tatimeve dhe detyrimeve të tjera të privileguara, mund t'i shpërndahen Ortakëve ose mund t'i shpërndahen ortakut të vetëm (në rast të shndërrimit me një ortak). Shpërndarja e fitimeve (dividendit) do të bëhet në raport me pjesët/kuotat që Ortakët zotërojnë në kapitalin e Shoqërisë.

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar të cilit i janë zbritur ose shtuar shumat respektive të humbjeve apo fitimeve të mbartura nga vitet e mëparshme. Humbjet e Shoqërisë do të mbulohen deri në kufirin e kapitalit themeltar dhe çdo Ortak ose ortak i vetëm (në rast të shndërrimit me një ortak), do të përgjigjet deri në kufirin e kontributit të tij në kapitalin themeltar të Shoqërisë.

Shpërndarja e fitimeve (dividendit) do të bëhet çdo 3 (tre) muaj sipas raportit me pjesët/kuotat që Ortakët zotërojnë në kapitalin e Shoqërisë. Shpërndarja e fitimeve (dividendit) çdo 3 (tre) muaj do të realizohet sipas "Aneksit 2" bashkelidhur këtij statuti.

Neni 27

Shkaqet e prishjes së Shoqërisë

Shoqëria prishet :

- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;
- nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
- me vendim të gjykatës.

NENI 28

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

Në këto raste Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqëri në likuidim e sipër ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 29

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 30

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin përgjatë veprimtarisë së Shoqërisë, zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërtën, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor në juridiksionin e së cilës përket mosmarrëveshja.

Neni 31

Ligji i Zbatueshëm

Të gjitha çështjet që nuk trajtohen nga ky Statut në mënyrë të veçantë, do të trajtohen dhe rregullohen në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Neni 32

Pavlefshmëria

Në rast se ndonjë nga dispozitat e këtij Statuti do të jetë e pavlefshme, e paligjshme ose e pazbatueshme, atëherë dispozita në fjalë nuk do të konsiderohet juridikisht, ndërkohë që të gjitha dispozitat dhe nenet e tjerë të këtij Statuti do të mbeten në fuqi dhe të vlefshëm.

Neni 33

Dispozita Përfundimtare

Ky Statut hyn në fuqi menjëherë pasi është nënshkruar nga Ortakët.

Ky Statut hartohet në 2 (dy) kopje në gjuhën Shqipe, secila me të njëjtën vlerë juridike.

ORTAKËT E SHOQËRISË
"Yellow Mood 25" SH.P.K

Shoqëria "Yellow Mood" SH.P.K.,

Perf. nga Administratori

Z. Evis Mumajesi,

Evis Mumajesi

**YELLOW
MOOD**

Z. Kledi Bahiti

Kledi Bahiti

[Signature]

Aneksi 1

"Raporti midis kontributeve në natyrë dhe rezultateve të punës së ortakut Z. Kledi Bahiti, si edhe të drejtat që burojnë nga kontributi në natyrë për ortakun Z. Kledi Bahiti ." - përshkruhet si mëposhtë:

Ortaku Z. Kledi Bahiti që zoteron 25 % (njëzetë e pesë përqind) pjesë të kapitalit themeltar të Shoqërisë, që është e barabartë me 32.500 Euro (tridhjetë e dy mijë e peseqind) euro e ka kontributin e tij në natyrë.

Ortakët në dakordësi midis tyre pranojnë se:

Ortaku Z. Kledi Bahiti do të sjell në shoqëri, si kontribut në natyrë punën dhe eksperiencën e tij në menaxhimin dhe administrimin e veprimtarisë së shoqërisë .

Kontributi në natyrë do të konsiderohet i shlyer nëse:

Ortaku Z. Kledi Bahiti arrin që me anë të punës së tij me menaxhim dhe administrim, shoqëria të nxjerr një fitim që është i barabartë me kapitalin e investuar nga ortakun "Yellow Mood" shpk dhe kjo të konsiderohet si kthimi i investimit të kontribuar nga ortakun "Yellow Mood" shpk. Pra, fitimet e shoqërisë të plotesojnë vlerën totale të investuar nga ortakun "Yellow Mood" shpk.

Në momentin që kjo vlerë është arritur në shoqëri Ortakun Z. Kledi Bahiti i quhet kuota e likuiduar.

Deri në realizimin e kushtit më sipër, ortakun Z. Kledi Bahiti nuk i ka të gjitha të drejtat mbi kuotën dhe kuota nuk quhet e likuiduar.

Vetëm me shlyerjen e kontributit në natyrë nepermjet kushtit të lartë përshkruar ortakun Z. Kledi Bahiti do të bëhet ortak me të drejta të plota duke zotëruar 25 % (njëzetë e pesë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë. Pas likuidimit total të kësaj kuote, ky ortak mund t'i transferoj këto kuota me miratimin e 51% të shoqërisë, si dhe e drejta e parablerjes nga ortakët e shoqërisë do të jenë në vlerën fillestare, pra në vlerën e 32.500 Euro (tridhjetë e dy mijë e peseqind) euro. Ky aneks për rregullat që parashikon zbatohet vetëm për Ortakun Z. Kledi Bahiti, përjashtohen rregullat e statutit deri në realizimin e kushtit që ky Aneks përmban.

Ky Aneks hartohet në 2 (dy) kopje dhe ndryshohet vetëm me miratimin me shkrim të dy ortakëve.

Shoqëria "Yellow Mood" SH.P.K.,

Perf. nga Administratori

Z. Evis Mumajesi

(Evis Mumajesi)

**YELLOW
MOOD**

Z. Kledi Bahiti

(Z. Kledi Bahiti)

Aneksi 2

Shpërndarja e fitimeve (dividendit), cdo 3 (tre) muaj, bazohet në Ligjin Nr 7638, datë 19/11/1992, Për shoqëritë Tregatre, Neni 214 dhe 215.

Pasi ky statut të depozitohet në QKB, shoqëria ka fituar tager të personit juridik dhe ka startuar aktivitetin e saj në shitje dhe blerje sipas objektit të veprimtarisë që ky statut përmban. Referuar Vitit kalendarik 2020 dhe mbylljes së tij më 31/12/2020 dhe përpilimi i pasqyrave financiare gjatë muajit Janar 2021, të cilat përbëjnë fitimin e vitit financiar 2020. Atëherë, Asambleja pasi ka aprovuar, nënshkruar dhe deklaruar pasqyrat financiare të vitit 2020, mund të marr vendimin për shpërndarjen e dividendit sipas koutave në dispozicion për secilin nga ortakët. Kjo shpërndarje bëhet bazuar edhe në një dokumentacion të nënshkruar dhe aprovuar nga Eksperti Kontabël.

Gjatë vitit 2021, cdo muaj pasardhës përlllogaritet Fitim-Humbja e muajit paraardhës dhe cdo 3 (tre) muaj, shoqëria nëpërmjet Vendimit të Asamblesë dhe aprovimit dhe nënshkrimit të ekspertit Kontabël realizon shpërndarjen e dividendit.

Kjo shpërndarje realizohet duke u bazuar në pikat si mëposhtë:

1. Shoqëria, veç rezerves së domosdoshme të ketë në dispozicion rezerva me një shumë të paktën të njëjtë me paradhëniet e shpërndara ose që një raport vërtetimi i bërë nga një ekspert kontabël i autorizuar të bëjë të njohur fitime neto më të mëdha se shumta e paradhënieve;
2. Shpërndarja e paradhënies të vendoset nga Asambleja e Përgjithshme, që përcaktojnë shumën. Shuma kalkulohet duke u bazuar në përlllogaritjen e fitimeve të muajit përkatës (shembull; Janar, Shkurt, Mars 2021), e cila duhet të jetë më e vogël se fitimi neto i shoqërisë për atë muaj. Përcaktimi i kësaj shume është në një hapësirë prej 70% të totalit të fitimit Neto të përlllogaritur për 3 mujorin përkatës.

Shpërndarja e dividendit përlllogaritet si shpërndarje paradhënie, e cila pas mbylljes së vitit financiar (Janar - Dhjetor) duhet të përlllogaritet edhe njëherë në Pasqyrat Financiare dhe të konatbilizohet nga Eksperti Kontabël. Pasi këto pasqyra janë përpiluar, nënshkruar dhe aprovuar nga ortakët e shoqërisë dhe nga Eksperti Kontabël, kalkulohet në qoftë se ortakëve duhet t'i shpërndahet dividend shtesë apo jo, kjo bazuar në mbulimin e shpenzimeve të tatimeve të detyrueshme të atij viti financiar dhe humbjeve të konsiderueshme (në qoftë se ka).

Cdo shpërndarje 3 (tre) mujore e dividendit duhet të shoqërohet me Kalkulimin e Fitimit neto për muajtë përkatës, kjo e aprovuar dhe nënshkruar nga Eksperti Kontabël dhe shoqëruar me Vendimin e Asamblesë së miratuar nga ortakët përkatës.

Ky Aneks hartohet në 2 (dy) kopje dhe ndryshohet vetëm me miratimin me shkrim të dy ortakëve.

Shoqëria "Yellow Mood" SH.P.K.,

Perf. nga Administratori

Z. Evis Mumajesi

Evis Mumajesi

**YELLOW
MOOD**

Z. Kledi Bahiti

Kledi Bahiti